



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 1 Mars 2022

Nr. 106

VENDIM

Objekt: Për konstatim të shkeljes së parashikuar në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”

Ndaj: Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”

Baza ligjore: Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 78, pika 6, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, si dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi relacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së në përfundim të procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë paraqitur 3 (tre) raporte shkeljesh nga monitoruesit për bashkinë Shkodër, ku pretendohet se në mënyrë të kundërligjshme dhe në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre



gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, subjekti zgjedhor Partia Demokratike, ka vendosur materiale propagandistike në vende të palejuara.

Monitoruesi ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve tre raporte me shkeljet e vërejtura, si më poshtë vijnë:

- 1- “Raporti mbi shkeljen e vërejtur” nr. 1159 prot., datë 23.02.2022 në të cilin është konstatuar se:
“Shkelja ndodhi sot në datë 23.02.2022 në orën 13:45 PM në bashkinë Shkodër në rrugën “Agron Zhyreku” ku është konstatuar vendosja e materialeve propagandistike në ambiente që bien në kundërshtim me parashikimit e vendosura në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike”
- 2- “Raporti mbi shkeljen e vërejtur” nr. 1286 prot., datë 28.02.2022 në të cilin është konstatuar se:
“Shkelja filloi sot, në datën 28.02.2022 në rrugën “Jeronim De Rada”, piaca “Truma” Shkodër, ku është vendosur material propagandistik në një kabinë elektrike për kandidatin për kryetar bashkie të subjektit zgjedhor Partia Demokratike, z. Xhemal Bushati”.
- 3- “Raporti mbi shkeljen e vërejtur” nr. 1309 prot., datë 01.03.2022 në të cilin është konstatuar se:
“Në ZAZ 4 Shkodër, janë vendosur dy postera afër Qendrës së Votimit së shkollës “Jordan Misja” dhe shkollës “Oso Kuka” ne fasada banimi.

Bashkëlidhur me raportet e konstatimit të shkeljeve janë dërguar fotografitë e materialeve propagandistike.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi që ka kompetencë lëndore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.



Meqenëse në KQZ janë paraqitur 3 (tre) “Raporte mbi shkeljet e vërejtura”, nga monitoruesit e bashkisë Shkodër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, shqyrtimin së bashku të raporteve.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ. Për zbatimin e ligjit të posaçëm përgjegjës është titullari i organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, të dhënat e paraqitura nga monitoruesi përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative ndaj subjektit zgjedhor Partisë Demokratike.

II.

Rrethanat e faktit

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur:

1- “Raporti mbi shkeljen e vërejtur” protokolluar pranë institucionit me nr. 1159 prot., datë 23.02.2022 në të cilin është konstatuar se: “Shkelja ndodhi sot në datë 23.02.2022 në orën 13:45 PM në bashkinë Shkodër në rrugën “Agron Zhyreku” ku është konstatuar vendosja e materialeve propagandistike në ambiente që bien në kundërshtim me parashikimit e vendosura në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike”. Referuar raportit të monitorimit, në rrugën “Agron Zhyreku”, Shkodër është vendosur material propagandistik në **fasadën e një godine banimi** për kandidatin për kryetar bashkie të subjektit zgjedhor Partia Demokratike, z. Xhemal Bushati.

Nëpërmjet shkresës nr. 1216 prot., datë 25.02.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i ka kërkuar subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, që në zbatim të nenit 79 të Kodit Zgjedhor dhe të nenit 3, pika 2 e udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të marrin masat e menjëhershme për heqjen e materialit propagandistik brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit. Në datën 28.02.2022, monitoruesi raportoi se nga ana e subjektit zgjedhor nuk është bërë heqja e materialit propagandistik nga fasada e banimit.

2- “Raporti mbi shkeljen e vërejtura”, protokolluar pranë institucionit me nr. 1286 prot., datë 28.02.2022, nga monitoruesi i cili kryen monitorimin për zgjedhjet e pjesshme të organeve të qeverisjes



vendore të datës 6 Mars 2022, për bashkinë Shkodër. Në këtë raport është konstatuar se subjekti zgjedhor koalicioni “Partia Demokratike” në kundërshtim me udhëzimin nr. 6 datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kanë vendosur materiale propagandistike në vende publike që ndalohen nga udhëzimi për afishimin e tyre.

Referuar raportit të monitorimit, në rrugën “Jeronim De Rada”, piaca “Truma” Shkodër është vendosur material propagandistik në një kabinë elektrike për kandidatin për kryetar bashkie të subjektit zgjedhor Partia Demokratike, z. Xhemal Bushati.

3-“Raporti mbi shkeljen e vërejtur” protokolluar pranë institucionit me nr. 1309 prot., datë 01.03.2022 në të cilin konstatohet se në ZAZ 4 Shkodër, subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” ka vendosur dy postera në fasada banimi afër Qendrës së Votimit së shkollës “Jordan Misja” dhe shkollës “Oso Kuka”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve administroi si materiale të dosjes hetimore administrative vendimin nr. 88, datë 03.02.2022, “Për përcaktimin e vendeve publike në territorin e bashkisë Shkodër, për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore”, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 536 datë 07.02.2022 dhe vendimin nr. 23 datë 27.01.2022, “Për përzgjedhjen e monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme të organeve të qeverisjes vendore, të datës 6 Mars 2022, për bashkitë Durrës, Vorë, Rrogozhinë, Lushnje, Shkodër dhe Dibër” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

III

Analiza juridike dhe konkluzione

Referuar nenit 2, pika 31, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, “... *materiale propaganduese statike janë materialet që i shërbejnë subjektit zgjedhor për promovimin e fushatës zgjedhore dhe që janë vendosur ose afishuar në vende ose hapësira publike me akses publik, si shtyllat e ndriçimit të rrugëve, fasadat e ndërtesave, sheshet, pjesët ballore të dyqaneve ose ndërtesave, përgjatë rrugëve të qyteteve, rrugëve ndërqytetëse etj*”.

Referuar neni 78, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, “...*gjatë fushatës zgjedhore çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të bëjë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme*”.

Referuar pikës 1, të nenit 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se... “*Jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë, përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike.*”



Vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit”.

Nga materialet e dosjes hetimore rezultoi se vendimi nr. 88 datë 03.02.2022 “Për përcaktimin e vendeve publike në territorin e bashkisë Shkodër, për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore” i bashkisë Shkodër, ka të përcaktuar në aneksin nr. 1 të tij, në mënyrë të qartë, vendet se ku mund të afishohen materialet propagandistike nga subjektet zgjedhore, distancën nga zyra zgjedhore dhe madhësinë e stendave elektorale së bashku me mesazhet dhe logot elektorale.

Sipas konstatimit kryer nga ana e monitoruesve të bashkisë Shkodër, vendosja e materialeve propagandistike nga ana e subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” është bërë në vende që shprehimisht ndalohen nga neni 3, pika 2 e udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” dhe pikës 7, të vendimit nr. 88 datë 03.02.2022 të bashkisë Shkodër.

Referuar nenit 3, pika 2, e udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: **fasadat e godinave të banimit**, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe **në shtyllat e ndriçimit**”.

Referuar raporteve të mësipërm dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, vendosja e materialeve propagandistike nga subjekti zgjedhor apo kandidatët e tyre është mjet i ligjshëm për bërjen e propagandës zgjedhore, por kjo duhet të kryhej në përputhje me përcaktimet e nenit 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 3, pika 2, të udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Materiali propagandues e tipit poster, e vendosur **mbi fasadat e godinave të banimit dhe kabinave elektrike**, bie në kundërshtim të hapur me dispozitat e sipërcituara.

Referuar nenit 79, pika 5, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 7, të udhëzimit nr. 9 datë 23.03.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike, edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ngarkohet policia bashkiake për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor dhe nga udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021, **duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore në vendet jashtë vendeve të lejuara.**



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”e “n”, pika 2, 78 pika 6, 79, 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Policia bashkiake Shkodër, të marrë masa të menjëhershme për heqjen e materialeve propagandistike të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

